



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Markuesit imunologjikë dhe imunogjenetikë në sëmundjet autoimune të gjëndrës tiroide”*
REF-34250-12-20-2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): Reagentë për laborator-33696500-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,493,773.33 (një milion katëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pik tridhjetë e tre) Lekë përjashtuar TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilën është e përcaktuar se: 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 2/c, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4.....” Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.2 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Argumentimi si më lart. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi

2.3.3 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:

- Specifikimet teknike janë hartuar nga drejtuesi i projektit me Shkresës nr. 554 prot., datë 27.02.2024, Shkresës “Kërkesë për saktësim” nr.554/1 prot., datë 18.03.2024 si dhe Shkresës “Kërkesë” nr. 948/6 prot, datë 28.05.2024 bashkëlidhur kërkesës dhe specifikimet teknike me miratimin nga AKKSHI , ardhur nga drejtuesi i projektit, kërkesë realizimin e projektit me objekt: **“Markuesit imunologjikë dhe imunogjenetikë në sëmundjet autoimmune të gjëndrës tiroide”** Specifikimet teknike, /termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 1.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Malli që kërkohet:

NR	EMËRTIMI	SPECIFIKIMET TEKNIKE	METODA	Njesia në teste/ kite/copë (ose sasi: ml/L)	Sasia Total në teste/ kite/copë (ose sasi: ml/L)	Kushte specifike
1	Komplet tipizimi genomik i lokusit gjenetik HLA-A me metodën SSP (sequence specific typing)	Komplet laboratorik xhenerik me pllakëza me mikrogropëza me prajmer për tipizim gjenomik me biologji molekulare nga ADN e ekstraktuar e lokusit gjenetik HLA-A. Metoda e përdorur është mikro-ssp (sequence specific priming) me anë të amplifikimit të sekuencës ADN të kërkuar me anë të taq-polimerazës dhe identifikim i sekuencës gjenomike të aplifikuar me elektroforezë në xhel. Në komplet përfshihen pllakëzat me prajmerat, tubat me d-mix, fletët mbuluese të pllakëzave, software identifikues dhe komponente të tjera të nevojshme.	Tipizim genomik me biologji molekulare i lokusit gjenetik HLA-A me metodën SSP (sequence specific typing)	TESTE	61 TESTE	Skadencia 1-vjecare
2	Komplet tipizimi genomik i lokusit gjenetik HLA-B me metodën SSP (sequence specific typing)	Komplet laboratorik xhenerik me pllakëza me mikrogropëza me prajmer për tipizim gjenomik me biologji molekulare nga ADN e ekstraktuar e lokusit gjenetik hla-b. Metoda e përdorur është mikro-ssp (sequence specific priming) me anë të amplifikimit të sekuencës ADN të kërkuar me anë të taq-polimerazes dhe identifikim i sekuencës genomike të aplifikuar me elektroforeze në xhel. Në komplet përfshihen pllakëzat me prajmerat, tubat me d-mix, fletët mbuluese të pllakëzave,	Tipizim genomik me biologji molekulare i lokusit gjenetik HLA-B me metodën SSP (sequence specific typing)	TESTE	64 TESTE	Skadencia 1-vjecare

		software identifikues dhe komponente të tjera të nevojshme				
3	Komplet tipizimi genomik i lokusit gjenetik HLA-C me metoden ssp (sequence specific typing)	Komplet laboratorik xhenerik me pllakeza me mikropropeza me primer per tipizim gjenomik me biologji molekulare nga adn e ekstraktuar e lokusit gjenetik hla-c. Metoda e perdorur eshte mikro-ssp (sequence specific priming) me ane te amplifikimit te sekuences adn te kerkuar me ane te taq-polimerazes dhe identifikim i i sekuences genomike te aplikuar me elektroforeze ne xhel. Ne komplet perfshihen pllakezat me prajmerat, tubat me d-mix, fletet mbuluese te pllakezave, software identifikues dhe komponente te tjere te nevojshme	Tipizim genomik me biologji molekulare i lokusit gjenetik hla-c me metoden ssp (sequence specific typing)	TESTE	64 TESTE	Skadencia 1-vjecare
4	Komplet tipizimi genomik i lokusit gjenetik HLA-DRB1 me metoden ssp (sequence specific typing)	Komplet laboratorik xhenerik me pllakeza me mikropropeza me primer per tipizim gjenomik me biologji molekulare nga adn e ekstraktuar e lokusit gjenetik hla-drb1. Metoda e perdorur eshte mikro-ssp (sequence specific priming) me ane te amplifikimit te sekuences adn te kerkuar me ane te taq-polimerazes dhe identifikim i i sekuences genomike te aplikuar me elektroforeze ne xhel. Ne komplet perfshihen pllakezat me prajmerat, tubat me d-mix, fletet mbuluese te pllakezave, software identifikues dhe komponente te tjere te nevojshem	Tipizim genomik me biologji molekulare i lokusit gjenetik hla-drb1 me metoden ssp (sequence specific typing)	TESTE	64 TESTE	Skadencia 1-vjecare
5	Komplet tipizimi genomik i lokusit gjenetik HLA-DQB1 me metoden ssp (sequence specific typing)	Komplet laboratorik xhenerik me pllakeza me mikropropeza me primer per tipizim gjenomik me biologji molekulare nga adn e ekstraktuar e lokusit gjenetik hla-dqb1. Metoda e perdorur eshte mikro-ssp (sequence specific priming) me ane te amplifikimit te sekuences adn te kerkuar me ane te taq-polimerazes dhe identifikim i i sekuences genomike te aplikuar me elektroforeze ne xhel. Ne komplet perfshihen pllakezat me prajmerat, tubat me d-mix, fletet mbuluese te pllakezave, software identifikues dhe komponente te tjere te nevojshem	Tipizim genomik me biologji molekulare i lokusit gjenetik hla-dqb1 me metoden ssp (sequence specific typing)	TESTS	64 TESTE	Skadencia 1-vjecare

Afatet e ekzekutimit: Brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i nënshkrimit të Kontratës

NJËSIA E PROKURIMIT: